REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

KORRIK 2021

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Korrik 2021

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021

Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

**E-mail:** **Juli.Lubonja@financa.gov.al**

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ______ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ______ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ______ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit ______ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ______ 5
4. Bilanci i Pagesave ______ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar______ 7
6. Kredia për Ekonominë ______ 8
7. Oferta e Parasë ______ 9
8. Depozitat sipas burimeve______ 10

**SEKTORI FISKAL** ______ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar ______ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve ______ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal ______ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** ______ **13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Korrik 2021, arriti në 101.6;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Korrik 2021 ishte 2.2 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Korrik 2021 ishte 103.43 lekë për dollarë dhe 122.32 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Korrik 2021 shënuan kuotën 0.48 përqind për ato 12–mujore; 0.24 përqind për depozitat 6-mujore; 0.16 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.42 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.5 përqind për huatë 12-mujore dhe 6.75 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.516.655 milionë lekë në muajin Korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 9.89 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të 2021 rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -117.27 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Janar - Korrik 2021 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -29.75 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -61.02 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Korrik 2021, arritën në rreth 281.81 miliardë lekë ose afërsisht 4.7% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 311.56 miliardë lekë ose rreth 5.6% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Korrik 2021 ishte 2.2%, një vit më parë ky ndryshim ishte 1.4%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Korrik 2021, krahasuar me Qershor 2021 është 0.1%. Një muaj më parë, Qershor 2021, IÇK shënoi rënie mujore prej 0.8%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Korrik 2020 shënoi rënie mujore prej 0.5%, në krahasim me muajin paraardhës.

Fig-1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +4.1%, duke kontribuar me +1.46 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- ”Komunikim”, me rritje vjetore +3%, duke kontribuar me +0.09 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +1.8%, duke kontribuar me +0.07 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +4.4%, duke kontribuar me +0.24 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” ka pësuar rritje vjetore të çmimit prej +1.4%, duke kontribuar me +0.06 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.2%.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2020 | 1.5 | 1.2 | 2.1 | 1.9 | 2.1 | 1.8 | **1.4** | 1.3 | 1.5 | 2.0 | 1.6 | 1.1 |
| 2021 | 0.4 | 1.1 | 1.2 | 1.9 | 1.8 | 1.6 | **2.2** | - | - | - | - | - |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Korrik 2021, arriti në 122.32 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.41 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Korrik, një euro u këmbye me 121.8 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Korrik 2021 arriti në 103.43 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.47 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Korrik, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 102.32 lekë/dollarë.

Fig-2




Ecuria e kursit të këmbimit Korrik 2021
Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin Korrik të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.37 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 4.68 përqind. Në pëgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.85 dollarë/euro për muajin Korrik 2021.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Korrik 2021, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.48 dhe 0.42 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.24 dhe 0.16 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 6 mujore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.01 dhe 0.05 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore shënuan rritje mujore prej 0.02 pikë përqindje dhe nuk ka ndryshim ato me afat 3 mujore.

Fig. 3




*Normat e interesit për depozitat (%)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht prej 0.06 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 6, 3 dhe 1 mujore shënuan rënie vjetore respektivisht 0.06, 0.14 dhe 0.01 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Korrik 2021, arritën përkatësisht kuotën prej 6.75 dhe 6.5 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje respektivisht me 0.99 dhe 0.61 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht me 0.94 dhe 0.14 pikë përqindje.

Fig-4




**Normat e interesit për huatë dhe bonot**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Korrik 2021 patën rënie mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.01 dhe 0.26 pikë përqindje.

# 4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e dytë të vitit 2021, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ në rënie të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth -117.2 milionë euro. Për gjysmën e parë të vitit 2021, defiçiti i llogarisë korente u ngushtua në -554 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -613 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2021, llogaria korente e ngushtoi deficitin në -243 milion euro, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020 që ishte -378 milion euro.

Fig-5




Bilanci i Pagesave T2 - 2021

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në gjysmën e parë të vitit 2021, Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +480.3 milion euro krahasuar me +1,407.1 miliard euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Ndërsa, vetëm për tremujorin e dytë të 2021, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në +66.6 mln euro, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +480.2 milionë euro ose -2.3%, krahasuar me +491.4 milion euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Ndërsa vetëm për tremujorin e dytë të 2021, IHD regjistruan vlerën +243.4 mln euro ose +1.8%, krahasuar me tremujorin e dytë të 2020.

Fig-6




Llogaria Korente T2 - 2021

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në gjysmën e parë të vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën +687.2 milionë euro ose +68.2%, krahasuar me +408.5 milion euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Në gjysmën e parë të vitit 2021, Remitancat shënuan rritje në vlerën +340.1 milionë euro, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2020.

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Korrik 2021, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 7.094 milionë lekë krahasuar me muajin Korrik të vitit 2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave paradepozituese me 37.228 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 9,234 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 10.232 milionë lekë e Bankave Paradepozituese.

Fig-7




**Ecuria e M.V.N. të sistemit Korrik'20 - Korrik'21**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.516.655 milionë lekë në muajin Korrik 2021, duke shënuar një rritje prej rreth 136.499 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 9.89 përqind.

Gjithashtu në muajin Korrik 2021, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 15,042 milionë lekë ose 1.0 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8




**Agregati M3 Korrik '20 - Korrik '21**

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Korrik 2021 arriti në rreth 629.108 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 38.438 milionë lekë, ose rritje me rreth 6.5 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (53.4%) dhe monedhave të huaja (46.6%).

Fig-9




***Rritja e stokut total të kredive***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Korrik 2021, zëri "Korporata të tjera jo-financiare", zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 60.3 përqind ose 379.340 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.54 përqind ose rreth 223.614 milionë lekë. Zërat "Korporata jo financiare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 1.9 dhe 2.21 përqind apo 11.911 dhe 13.883 milionë lekë.

Fig-10




***Përberja e kredive Korrik '21***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Korrik 2021, zëri "Koorporata të tjera jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.23 përqind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 24.98 përqind. "Koorporata të tjera financiare"dhe "Koorporata jofinanciare publike" kontriubojnë përkatësisht me 2.21 dhe 0.58 përqind secili.

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 362.135 milionë lekë në fund të muajit Korrik 2021. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Korrik 2021 ka shënuar rritje mujore prej 0.24 përqind dhe rritje vjetore prej 0.36 përqind, duke arritur nivelin 23.88 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.41 përqind, dhe rritje vjetore prej 0.62 përqind, duke shënuar nivelin 31.4 përqind.

Fig-11




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Korrik 2021, kanë shënuar rritje vjetore prej 57.901 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 78 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Korrik 2021 shënuan rritje prej 41.049 milionë lekë në krahasim me muajin Korrik 2020. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 80.6 përqind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Korrik 2021, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 80.6 përqind, ndjekur nga "Koorporata të tjera jofinanciare", me rreth 14.8 përqind dhe nga "Koorporata jo-financiare publike" me 2.7 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Koorporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 78 përqind dhe rreth 19.1 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 79.2 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 914,055 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga "Koorporata të tjera jofinanciare" (197.566 milionë lekë), "Koorporata të tjera financiare" (22.513 milionë lekë), dhe "Koorporata jofinanciare publike" (19.080 milionë lekë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth (1.307 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Korrik 2021, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.154.521 milionë lekë.

Fig-14




Përberja e depozitave Korrik '21

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 7.894 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 98.951 milionë lekë.

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Korrik 2021 janë mbledhur rreth 281.805 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 311.561 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 257.278 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 53.698 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 50.17% janë financime të brëndshme.

Fig - 15




***Treguesit Fiskal, Korrik 2021***

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 262.472 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 16.578 miliardë lekë (ose rreth 24.1% më shumë se plani i periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 64.433 miliardë lekë (ose rreth 6% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 13.049 miliardë lekë (ose rreth 9.2% më shumë se plani për periudhën Janar-Korrik 2021).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 257.278 miliardë lekë, 48.562 miliardë lekë (18.9% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 23.077 miliardë lekë (9%) për shpenzime interesi, 29.592 miliardë leke (11.5%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 618 miliardë lekë (0.24%) për subvencione, 110.198 miliardë lekë (42.8%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 28.486 miliardë lekë (11.07%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 16.745 miliardë lekë (6.51%) për shpenzimet e tjera. Shpenzimet kapitale u financuan 50.17% me financim të brëndshëm.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Korrik 2021 ishin rreth 281.805 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 262.472 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 13.049 miliardë lekë.

**Tab - 2**

**Të ardhurat gjatë muajit Janar - Korrik 2021 (mld Lekë)**
**Revenues during January - July 2021 (in billion ALL)**

| Burimi (Source) | Korr '21 Jul '21 | Korr '20 Jul '20 | Ndrysh(%) Chang (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH (VAT) | 83.92 | 69.89 | +20.1 |
| Taksa doganore (Custom Tax) | 4.04 | 3.4 | +18.9 |
| Akcizat (Excise) | 28 | 23.9 | +17.1 |
| Tatimi mbi fitimin (Profit Tax) | 19.62 | 15.43 | +27.2 |
| Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax) | 22.8 | 19.9 | +19.3 |
| Taksat nacionale (National Tax) | 23.05 | 18.18 | +26.8 |

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: July - 2021*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: July - 2021*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 29.76 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Korrik 2021, u financua kryesisht nga financimi i brëndshëm.

Për periudhën Janar-Korrik 2021, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 281.805 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 311.561 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Korrik 2021, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 262.472 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 257.278 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 110.198 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

| Tab - 1 | **Indeksi i çmimeve të konsumit**<br>*Consumer price index (in %)* |
|---|---|

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | Month |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | |
| **Janar** | 0.9 | 1.5 | 1.5 | 1.6 | 1.9 | 1.3 | 0.9 | 1.5 | 1.5 | 1.6 | 1.9 | 1.3 | 1.5 | 2.8 | 1.7 | 1.9 | 1.5 | 0.4 | **January** |
| Shkurt | 1.1 | 0.5 | 0.8 | 0.6 | 0.4 | 1.1 | 1.0 | 1.0 | 1.1 | 1.1 | 1.1 | 1.2 | 0.2 | 2.2 | 2.1 | 1.7 | 1.2 | 1.1 | February |
| Mars | 0.5 | 0.4 | 0.3 | -0.3 | 0.6 | 0.7 | 0.8 | 0.8 | 0.9 | 0.6 | 0.9 | 1.0 | 0.3 | 2.1 | 2.0 | 1.1 | 2.1 | 1.2 | March |
| Prill | -0.4 | -0.6 | -0.5 | -0.2 | -0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.6 | 0.8 | 0.3 | 1.9 | 2.1 | 1.4 | 1.9 | 1.9 | April |
| Maj | -1.2 | -1.2 | -1.2 | -1.0 | -0.8 | -0.9 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | 0.1 | 0.3 | 0.5 | 0.7 | 2.0 | 2.1 | 1.5 | 2.1 | 1.8 | May |
| Qershor | -0.6 | -0.4 | -0.1 | -0.3 | -0.6 | -0.8 | 0.04 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.2 | 0.3 | 1.2 | 2.2 | 2.4 | 1.3 | 1.8 | 1.6 | June |
| Korrik | 0.0 | -0.1 | -0.3 | -0.1 | -0.5 | **0.1** | 0.04 | 0.0 | 0.1 | 0.0 | 0.1 | **0.2** | 1.9 | 2.0 | 2.3 | 1.5 | 1.4 | **2.2** | July |
| Gusht | 0.9 | 0.4 | 0.4 | 0.3 | 0.2 | | 0.14 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | | 2.0 | 1.6 | 2.2 | 1.5 | 1.3 | | August |
| Shtator | 0.4 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.4 | | 0.17 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | | 1.8 | 1.6 | 2.1 | 1.3 | 1.5 | | September |
| Tetor | -0.2 | 0.0 | -0.2 | -0.2 | 0.2 | | 0.04 | -0.1 | -0.1 | -0.1 | 0.1 | | 1.8 | 1.6 | 2.1 | 1.3 | 2.0 | | October |
| Nëntor | 0.1 | -0.1 | -0.2 | -0.2 | -0.5 | | 0.12 | 0.1 | 0.1 | 0.0 | 0.1 | | 1.9 | 1.7 | 1.8 | 1.4 | 1.6 | | November |
| Dhjetor | 0.1 | -0.1 | -0.2 | -0.2 | 0.3 | | 0.05 | -0.1 | -0.1 | -0.1 | 0.1 | | 1.9 | 1.7 | 1.8 | 1.4 | 1.1 | | December |

***Burimi** : INSTAT* ***Source** : INSTAT*

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
*Exchange rate*

| Monedha | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 125.96 | 124.15 | 119.10 | 107.99 | 109.85 | 108.65 | 101.61 | 102.22 | 103.61 | 102.89 | 101.24 | 101.93 | 103.43 | USD |
| EURO | 139.74 | 137.36 | 134.15 | 127.59 | 123.01 | 123.77 | 123.53 | 123.61 | 123.34 | 123.10 | 123.01 | 122.83 | 122.32 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 125.79 | 128.17 | 111.10 | 107.82 | 108.64 | 100.84 | 101.97 | 101.99 | 104.91 | 101.89 | 100.96 | 103.10 | 102.32 | USD |
| EURO | 137.28 | 135.23 | 132.95 | 123.42 | 121.77 | 123.70 | 123.61 | 123.67 | 123.16 | 123.19 | 123.05 | 122.67 | 121.80 | EURO |

***Burimi** : Banka e Shqipërisë* ***Source** : Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
*Annual Interest Rates (in ALL)*

| Në përqindje | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Norma e depozitave* | | | | | | | | | | | *Deposits rates* |
| 12-M | 0.73 | 0.49 | 0.41 | 0.47 | 0.63 | 0.45 | 0.47 | 0.52 | 0.49 | 0.48 | 12-M |
| 6-M | 0.59 | 0.42 | 0.35 | 0.32 | 0.29 | 0.34 | 0.30 | 0.40 | 0.29 | 0.24 | 6-M |
| 3-M | 0.28 | 0.23 | 0.21 | 0.15 | 0.15 | 0.16 | 0.17 | 0.15 | 0.16 | 0.16 | 3-M |
| 1-M | 0.76 | 0.66 | 0.49 | 0.41 | 0.40 | 0.40 | 0.42 | 0.38 | 0.40 | 0.42 | 1-M |
| *Norma e huasë* | | | | | | | | | | | *Lending rates* |
| 12-M | 5.66 | 6.25 | 6.05 | 6.85 | 6.56 | 5.35 | 6.34 | 5.79 | 5.89 | 6.50 | 12-M |
| 6-M | 8.12 | 7.07 | 6.28 | 5.56 | 5.39 | 5.84 | 5.94 | 6.12 | 5.76 | 6.75 | 6-M |
| *Norma e letrave me vlerë* | | | | | | | | | | | *Securities rates* |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | - | - | - | 1.09 | 1.29 | 1.37 | 1.37 | 0.89 | 0.96 | 0.99 | 3-M |
| 6-M | - | - | - | - | 1.58 | 1.76 | - | 1.25 | - | - | 6-M |
| 12-M | 1.43 | 1.69 | 1.77 | 1.92 | 2.06 | 2.13 | 1.83 | 1.67 | 1.49 | 1.48 | 12-M |

**Burimi :** *Banka e Shqipërisë* **Source** : *Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **35,215** | **69,540** | **109,350** | **153,008** | **191,491** | **234,320** | **281,805** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **108** | **331** | **1,087** | **2,653** | **2,711** | **3,846** | **6,284** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **33,908** | **66,871** | **103,982** | **142,401** | **179,308** | **219,009** | **262,472** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **23,093** | **46,219** | **72,778** | **97,598** | **123,217** | **151,111** | **181,461** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 11,205 | 21,627 | 31,730 | 43,046 | 55,237 | 68,406 | 83,922 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,553 | 3,713 | 10,579 | 12,994 | 15,134 | 17,653 | 19,624 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 3,185 | 6,607 | 10,346 | 14,049 | 18,293 | 23,176 | 27,996 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 3,382 | 6,493 | 9,304 | 12,905 | 16,004 | 19,120 | 22,832 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 3,394 | 6,842 | 9,312 | 12,533 | 15,875 | 19,434 | 23,049 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 375 | 938 | 1,506 | 2,071 | 2,675 | 3,322 | 4,038 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **1,344** | **2,836** | **4,920** | **8,295** | **10,961** | **13,966** | **16,578** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 283 | 572 | 977 | 1,988 | 2,789 | 3,566 | 4,027 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 2 | 10 | 83 | 255 | 278 | 292 | 334 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 1,060 | 2,254 | 3,860 | 6,051 | 7,894 | 10,108 | 12,217 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardh nga fondet speciale** | **9,470** | **17,816** | **26,284** | **36,508** | **45,130** | **53,932** | **64,433** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 8,127 | 15,285 | 22,587 | 31,251 | 38,576 | 46,155 | 55,095 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 1,333 | 2,387 | 3,457 | 4,868 | 5,965 | 7,075 | 8,517 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 11 | 144 | 240 | 389 | 589 | 701 | 821 | Compensation income in the value of owners |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **1,200** | **2,339** | **4,281** | **7,954** | **9,472** | **11,465** | **13,049** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | | | | 1,486 | 1,486 | 1,486 | 1,486 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 748 | 1,511 | 2,740 | 4,404 | 5,301 | 6,627 | 7,571 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Tarifat shërbimeve | 193 | 323 | 676 | 869 | 1,024 | 1,270 | 1,530 | Utility fees |
| 4 | Të tjera | 259 | 505 | 861 | 1,191 | 1,658 | 2,078 | 2,458 | Others |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **33,208** | **70,042** | **118,167** | **167,849** | **212,160** | **263,461** | **311,561** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **31,127** | **63,237** | **101,632** | **140,000** | **175,247** | **216,421** | **257,278** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **6,421** | **13,212** | **20,188** | **27,300** | **34,188** | **41,391** | **48,562** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 5,510 | 11,326 | 17,312 | 23,426 | 29,312 | 35,496 | 41,564 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 904 | 1,855 | 2,825 | 3,801 | 4,778 | 5,760 | 6,733 | Social insurance contributions |
| 3 | Arsimi I larte nga te ardhurat e veta | 6 | 31 | 50 | 73 | 97 | 134 | 265 | Higher education from its own income |
| **I.2** | **Interesat** | **4,547** | **6,922** | **9,660** | **12,320** | **13,948** | **18,325** | **23,077** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 3,509 | 5,304 | 7,497 | 9,598 | 10,657 | 11,785 | 15,523 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 1,038 | 1,618 | 2,163 | 2,721 | 3,291 | 6,540 | 7,554 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **2,366** | **5,440** | **10,486** | **15,505** | **20,194** | **25,263** | **29,592** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvencionet** | **88** | **177** | **255** | **334** | **415** | **500** | **618** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime për fonde speciale** | **13,738** | **27,152** | **43,662** | **59,910** | **74,991** | **92,403** | **110,198** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 10,493 | 20,812 | 31,480 | 42,610 | 53,932 | 66,772 | 80,890 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,632 | 5,453 | 11,000 | 15,876 | 19,635 | 24,092 | 27,769 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit të pronarëve | 613 | 887 | 1,182 | 1,424 | 1,424 | 1,538 | 1,538 | Owners' Compensation Fund |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **2,466** | **6,530** | **10,762** | **15,458** | **19,810** | **24,333** | **28,486** | **Local budget expenditure** |
| **I.7** | **Shpenzime të tjera** | **1,503** | **3,803** | **6,619** | **9,173** | **11,701** | **14,207** | **16,745** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 84 | 175 | 281 | 386 | 482 | 566 | 638 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,219 | 3,176 | 5,493 | 7,628 | 9,700 | 11,859 | 13,940 | Economic Aid |
| 3 | Bonusi I lindjeve | 200 | 400 | 700 | 900 | 1,200 | 1,400 | 1,700 | Birth bonus |
| **I.8** | **Transferime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | **Capital transfers** |
| **II** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | 92 | 137 | 189 | 240 | 288 | 337 | 384 | **Reserve fund/contigency** |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **1,983** | **5,761** | **13,391** | **27,609** | **36,625** | **46,703** | **53,698** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | | 2,756 | 7,656 | 13,373 | 18,855 | 24,117 | 26,939 | Domestically financing |
| 2 | Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte | | 39 | 64 | 167 | 224 | 349 | 391 | From higer education system's own revenues |
| 3 | Financimi Huaj | 1,983 | 2,966 | 5,670 | 7,164 | 8,377 | 11,385 | 12,587 | Foreign financed |
| **IV** | **Fondi i rindertimit** | 6 | 907 | 2,955 | 6,904 | **9,169** | **10,851** | **13,781** | **Reconstruction fund** |
| **V.** | **DEFICITI** | **2,007** | **-502** | **-8,817** | **-14,841** | **-20,668** | **-29,141** | **-29,756** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-2,007** | **502** | **8,817** | **14,841** | **20,668** | **29,141** | **29,756** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-2,780** | **1,599** | **-9,057** | **1,971** | **8,488** | **18,435** | **19,906** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 17 | 20 | 25 | 33 | 35 | 104 | 107 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | 7,460 | 9,527 | 17,298 | 20,331 | 24,684 | 31,986 | 36,224 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -10,257 | -7,948 | -26,379 | -18,393 | -16,231 | -13,655 | -16,425 | Others |
| **V.3** | **I huaj** | **773** | **-1,098** | **17,874** | **12,870** | **12,181** | **10,706** | **9,850** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 1,665 | 2,560 | 4,397 | 6,144 | 5,439 | 8,457 | 9,649 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | 352 | 222 | 366 | -745 | -13,872 | -17,267 | -379 | Chang. of stat. Account |
| 3 | Ripagesat | -1,245 | -3,880 | -6,279 | -11,919 | 1,224 | 127 | -18,810 | Repayments |
| 4 | Mbështetje Buxhetore | | | 19,390 | 19,390 | 19,390 | 19,390 | 19,390 | Budgetary Support |

***Burimi** : Ministria e Financave dhe Ekonomisë* ***Source** : Ministry of Finance and Economy*

**Tab - 5** **Tabela e investimeve 2021**

*Table of investments 2021*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | Prill<br>April | Maj<br>May | Qershor<br>June | Korrik<br>July | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | - 2,779 | 1,599 | - 9,057 | 1,949 | 8,488 | 18,435 | 19,906 | **Domestic financing** |
| *Në %* | 138.3 | 321.0 | -102.8 | 13.2 | 41.1 | 63.3 | 66.9 | *In %* |
| **Financim i huaj** | 770 | - 1,101 | 17,871 | 12,867 | 12,181 | 10,706 | 9,850 | **Foreign financing** |
| *Në %* | -38.3 | -221.0 | 202.8 | 86.8 | 58.9 | 36.7 | 33.1 | *In %* |
| **Totali** | -2,010 | 498 | 8,814 | 14,816 | 20,668 | 29,141 | 29,756 | **Total** |
| *Në %* | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | *In %* |

**Burimi**: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Source**: Ministry of Finance and Economy

Tab - 6

## TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2021
## CUSTOMS AND TAX REVENUES 2021

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë doganore | 375 | 938 | 1,506 | 2,071 | 2,675 | 3,322 | 4,038 | Customs Duties |
| TVSH | 7,683 | 15,813 | 25,772 | 35,908 | 45,787 | 56,927 | 68,321 | V.A.T |
| Akcizë | 3,185 | 6,607 | 10,346 | 14,049 | 18,293 | 23,176 | 27,996 | Excises |
| Të tjera (Renta Minerare) | 247 | 438 | 625 | 800 | 1,055 | 1,242 | 1,439 | Others (Mineral Rent) |
| **TOTALI** | **11,491** | **23,797** | **38,249** | **52,829** | **67,809** | **84,668** | **101,794** | **Total** |

### TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TVSH | 3,522 | 5,814 | 5,958 | 7,138 | 9,450 | 11,479 | 15,601 | V.A.T |
| Tatim mbi fitimin | 1,553 | 3,713 | 10,579 | 12,994 | 15,134 | 17,653 | 19,624 | Profit Tax |
